

**RREGULLORE E LICENCIMIT**

**PËR**

**PROCEDURAT E DHËNIES DHE RINOVIMIT TË LICENCAVE  
PROFESIONALE PËR SUBJEKTET JURIDIKE E FIZIKE QË USHTROJNË  
VEPRIMTARI NË SEKTORIN E FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E  
PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

*Miratuar me Vendim të KKRR nr. 29 datë 08.12.2009  
Ndryshuar me Vendim të KKRR nr. 30, datë 07.12.2012  
Ndryshuar me Vendim të KKRR nr. 50, datë 30.12.2013  
Ndryshuar me Vendim të KKRR nr. 484, datë 14.10.2022  
Ndryshuar me Vendim të KKRR nr. 35, datë 14.11.2025*

## **PËRMBAJTJA**

<b>Kapitulli I</b>	<b>3</b>
<b>Kapitulli II</b>	<b>5</b>
<b>Kapitulli III</b>	<b>8</b>
<b>Anekset</b>	<b>12</b>

## **Kapitulli I – Dispozita të Përgjithshme**

Kjo rregullore hartohet në zbatim të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 (ndryshuar me ligjin nr. 9352, datë 3.3.2005; ligjin nr.9584, datë 17.07.2006 dhe ligjin nr. 9915, datë 12.05.2008) “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, kreu VI ”Administrimi dhe procedurat”, neni 26 “Kuatrri rregullator” Pika 1 si dhe të VKM nr. 958, datë 06.05.2009.

### **Neni 1 – Autoriteti**

Komisioni Kombëtar i ERRU është autoriteti i vetëm në Republikën e Shqipërisë që jep licencat përkatëse për të gjithë subjektet juridike dhe fizike të cilët veprojnë në sektorin e furnizimit me ujë, largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura.

### **Neni 2 – Qëllimi i Rregullores**

Kjo rregullore përcakton procedurat e licencimit për ushtrimin e aktiviteteve të parashikuara në ligj. Rregullorja ka për qëllim të specifikojë kriteret dhe kushtet për dhënien, modifikimin, dhe rinovimin e licencës. Rregullorja përcakton të gjitha detajet e duhura në lidhje me kohëzgjatjen e licencës, pagesat që duhen kryer për çdo tip aplikimi tek autoriteti i ERRU, etj.

### **Neni 3 – Përkufizime**

Në këto rregulla termat e mëposhtme do të kenë këto kuptime:

“**ERRU**” do të thotë Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura që vepron sipas ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 (ndryshuar me ligjin nr. 9352, datë 3.3.2005; ligjin nr.9584, datë 17.07.2006 dhe ligjin nr.9915, datë 12.05.2008) “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”

“**Komisioni Kombëtar Rregullator - KKRR**” do të thotë organi vendimmarrës i ERRU-s, i përbërë nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara nga ligji nr. 8102, datë 28.03.1996 (ndryshuar me ligjin nr. 9352, datë 3.3.2005; ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006 dhe ligjin nr. 9915, datë 12.05.2008) “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”

“**Licencë**” do të thotë leja profesionale që i jepet një personi fizik apo juridik në përputhje me ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996, të ndryshuar si dhe VKM nr. 958, datë 06.05.2009 për ushtrimin e aktivitetit në sektorin e furnizimit me ujë, largimit të ujërave të ndotura dhe përpunimit të tyre.

“**I licencuar**” do të thotë një person juridik apo fizik që mban një licence të dhënë nga ERRU për të operuar në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura sipas kategorive të dhëna nga KKRR.

“**Formati i Licencës**” do të thotë formati i lejes profesionale, i miratuar me vendim të KKRR.

“**Aplikues**” do të thotë çdo person fizik apo juridik që aplikon për një procedim sipas kësaj Rregulloreje.

“**Dokumentat e Aplikimit**” do të thotë dokumentat e përcaktuara në VKM nr. 958, datë 06.05.2009 dhe formulari i aplikimit të plotësuar nga aplikuesi.

“**Operatorë**” janë subjektet juridike apo fizike të licencuara nga ERRU, që operojnë në sistemet e furnizimit me ujë, kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe trajtimit të tyre.

“**Pagesa e licencimit**” janë pagesa, të vendosura nga ERRU, të detyrueshme për të gjithë operatorët që operojnë në sistemet e furnizimit me ujë të cilat duhet të bëhen përpara marrjes së Licencës përkatëse.

“**Drejtues Ligjor**” do të thotë personi fizik i emëruar apo të caktuar me një marrëveshje juridike, nga pronari për të administruar në përputhje me ligjin në sistemet përkatëse të furnizimit me ujë, largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura.

“**Drejtues Teknik**” do të thotë një individ me aftësitë e duhura për drejtimin teknik të Operatorit të licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator i cili përmbush të gjitha kriteret e kërkuara nga ligji dhe VKM nr. 958, datë 06.05.2009.

#### **Neni 4 –Licencat**

Sipas VKM nr. 958, datë 06.05.2009, ERRU lëshon licenca për veprimtaritë e mëposhtme:

- a) **Kategoria A**, GRUMBULLIMI DHE SHPËRNDARJA E UJIT PËR KONSUM PUBLIK
- b) **Kategoria B**, PËRPUNIMI I UJIT PËR KONSUM PUBLIK
- c) **Kategoria C**, GRUMBULLIMI DHE LARGIMI I UJËRAVE TË NDOTURA
- ç) **Kategoria D**, PËRPUNIMI I UJËRAVE TË NDOTURA

#### **Neni 5 – Kohëzgjatja e Vlefshmërisë së Licencës**

1. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencave të lëshuara nga KKRR për kategoritë e parashikuara në Licencë do të përcaktohet nga KKRR dhe do të jetë jo shumë se **4 vjet**.

2. Rinovimi i Licencës brenda këtij afati për shkak të ndryshimit të zonës së shërbimit apo kategorive të shërbimit do të ketë një kohëzgjatje e cila do të përcaktohet nga KKRR por në çdo rast jo më shumë se 4 vjet.

## **Kapitulli II – Procedurat e Aplikimit**

### **Neni 6 – E drejta për të aplikuar për një Licencë**

1. Ka të drejtë të aplikojë për një licencë të lëshuar nga ERRU, çdo person fizik apo juridik, vendas apo i huaj që plotëson kërkesat e ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, të ndryshuar si dhe VKM nr. 958, datë 06.05.2009 për ushtrimin e aktivitetit në sektorin e furnizimit me ujë, largimit të ujërave të ndotura dhe përpunimit të tyre.

### **Neni 7 – Paraqitja e Aplikimit**

1. Aplikimi konsiston në plotësimin e formularit të aplikimit për licencë të hartuar dhe aprovuar nga ERRU (shih Aneksin 1 bashkëlidhur) si dhe në dorëzimin e të gjithë dokumentacionit të përcaktuar në VKM nr. 958, dt. 06.05.2009.
2. Aplikuesi do të kryej pagesën e licencimit në momentin e paraqitjes së aplikimit siç përcaktohet në nenin 17, pika 1 në ligjit 8102 datë 28.03.1996 (ndryshuar me ligjin nr. 9352, datë 03.03.2005; ligjin nr.9584, datë 17.07.2006 dhe ligjin nr. 9915, datë 12.05.2008) **“Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”**. Pagesa e licencimit do bëhet sipas tabelës bashkëlidhur kësaj rregulloreje të dhënë në Aneksin 5 dhe 5/1 të saj.
3. Dokumentacioni i kërkuar në pikën 1 të këtij neni duhet të jetë në gjuhën shqipe, origjinal ose fotokopje e noterizuar. Vërtetimet dhe deklaratimet nga institucionet shtetërore apo lokale duhet të jenë lëshuar jo më parë se **6 muaj** nga momenti i paraqitjes së aplikimit.
4. Dokumentacioni teknik i kërkuar duhet të jetë i hartuar dhe i firmosur nga drejtuesi teknik i operatorit ndërsa formulari i aplikimit për licencë duhet të jetë i firmosur nga drejtuesi ligjor dhe me vulën e të Licencuarit.

### **Neni 8 – Format i Licencës**

Formati i licencës miratohet nga KKRR dhe i bashkëlidhet kësaj rregulloreje.

## Neni 9 – Kushtet, kriteret dhe kufizimet

- a) Aplikimi për licence dhe dokumentat shoqerues të tij sipas kësaj rregulloreje dërgohen zyrtarisht në adresën e ERRU. Dokumentat e kërkuara në përputhje me VKM nr. 958, datë 06.05.2009 duhet të jenë origjinal ose të njësuar me origjinalin. Në aplikim shënohet dhe adresa e saktë për komunikim mes operatorit dhe ERRU.
- b) Për të vlerësuar aftësinë e mjaftueshme profesionale dhe kapacitetin profesional të drejtuesit teknik të operatorit, gjykohet mbi dokumentacionin e plotësuar nga aplikuesi sipas procedurave dhe kriterëve të percaktuara në VKM nr. 958, datë 06.05.2009 dhe në këtë rregullore. KKRR ka të drejtë të kërkojë dokumente apo informacione plotësuese.
- c) Licencat e operatorëve jepen me afat të përcaktuar në nenin 5. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura në mungesë të Drejtuesit/ve teknikë të operatorëve të licencuar nga KKRR. Në rast të konstatimit të kësaj shkelje, KKRR duhet të penalizojë me gjobë operatorin në përputhje me ligjin.
- d) Kur drejtuesi teknik ose drejtuesi ligjor është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 3 muaj, invaliditet, ndarje nga jeta), Operatorët e licencuar kanë detyrimin që brenda 30 ditëve kalendarike të paraqesin njoftimin pranë ERRU së bashku me kërkesën dhe dokumentat përkatëse për drejtuesin e ri teknik apo ligjor. Si rregull përgjegjësitë e drejtuesit teknik apo ligjor të operatorit të licencuar për këtë periudhë (nga kontraktimi deri nëshqyrtimin e kërkesës) mbulohen nga Drejtuesi i ri i kontraktuar.
- e) Kur KKRR vendos mospranim të kërkesës ose kur ka mungesë të dokumentacionit të kërkuar më sipër, ERRU, brenda 15 ditëve kalendarike, i dërgon njoftim për plotësim dokumentacioni sipas VKM nr. 958 datë 06.05.2009.
- f) Kur operatori dhe drejtuesi teknik kanë kontratë noteriale me afat të caktuar, (rregull i detyruar), Operatori jo më vonë se 30 ditë para mbarimit të afatit njofton ERRU për drejtuesin e ri teknik ose zgjatjen e afatit të kontratës. Kur ERRU nuk ka njoftim nga operatori apo drejtuesi teknik për mbarimin e kontratës sipas afatit, kontrata për periudhën në vijim do të quhet e parregullt dhe përgjegjësia sipas ligjit i mbetet drejtuesit ligjor të operatorit të licencuar.
- g) Afati kohor për të kërkuar shtesë të kategorive me të njëjtët drejtues teknik me të cilët operatori disponon licencë bëhet jo më parë se 6 muaj nga aplikimi paraardhës.

## Neni 10 – Modifikimi i Licencës

Në përgjigje të çdo kërkesë të të licencuarit ose me iniciativën e vet, KKRR mund të modifikojë termat dhe kushtet e një licence, duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 26 të ligjit nr.8102, datë 28.03.1996 “Kuatri rregullator”

KKRR mund të vendosë modifikimin e licencës në rastet e mëposhtme:

- a) kur ka ndryshime të rrethanave të leshimit të licencës (kuadri ligjor, vendime të gjykatës, VKM) ose të disa ngjarjeve që ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në administrimin e sistemeve të furnizimit me ujë, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, etj.
- b) kur ka ndryshime ligjore, teknike ose financiare që bëjnë të pamundur plotësimin e pjesëshëm ose të plotë të kushteve të vendosura në licencë;
- c) kur ka ndryshime në strukturën e të licencuarit duke përfshirë ndarjen, bashkimin ose transformimin në një person tjetër fizik apo juridik.

Nëse KKRR vendos të ndryshojë një licence, duhet t'i lëshojë të licencuarit një licencë me përmbajtje të ndryshuar, duke shfuqizuar pjesët e ndryshuara të licencës së mëparshme.

Në rastin e modifikimit/ndryshimit të licencës, KKRR zbaton të njëjtat afate dhe procedura si për licencimin duke kërkuar dhe informacionin shtesë nëse është e nevojshme.

## Neni 11 – Rinovimi i licencës

Jo më vonë se **3 muaj** para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë, personi juridik duhet të kërkojë pranë ERRU rinovimin e licences duke paraqitur dokumentat e mëposhtme;

- a. Kërkesën me shkrim për licencim sipas formatit të aprovuar nga ERRU duke shprehur qartë kategoritë e shërbimit që kërkon të kryejë si dhe zonën e shërbimit ku do të operojë.
- b. Formularin e Aplikimit të aprovuar nga ERRU të plotësuar sipas kërkesave të ligjit, VKM dhe kësaj rregulloreje.
- c. Dokumentacionin e kërkuar sipas VKM nr.958, datë 06.05.2009.

Afati i përdorimit të licencës është jo më shumë se **4 vjet** me të drejtë rinovimi.

Në kërkesën për rinovim të Licencës, i licencuari paraqet ndryshimet në kushtet e saj, në se ka të tilla, ose konfirmon kushtet e licencës, afati i së cilës ka përfunduar.

Rinovimi i licensës do të bëhet edhe në rast se ndryshon një nga kushtet e dhënies së saj (ndryshimi i zonës së shërbimit, etj), pavaresisht se afati i vlefshmërisë nuk ka përfunduar.

ERRU mund të kërkojë nga subjekti çdo informacion shtesë të konsideruar të nevojshëm për procesin e rinovimit të licensës.

KKRR do të marrë vendimin për rinovim ose jo të licensës jo më vonë se **30 ditë** nga fillimi i procedurave për shqyrtimin e një aplikimi, konform kësaj rregullore.

### **Neni 11 /1**

Në rastet e ndryshimit të elementeve të vendimit të licensës, brenda periudhës së vlefshmërisë, operatori duhet që 30 ditë nga momentit i këtij ndryshimi të paraqesë kërkesën për ndryshim pranë ERRU-së. Në zbatim të pikës 2 të VKM nr. 958, datë 06.05.2009 e ndryshuar, ku është listuar dokumentacioni i nevojshëm për licencim, operatori duhet të paraqesë vetëm dokumentacionin e ndryshuar. Dokumentacioni i cili nuk ndryshon do të administrohet nga dosja e aplikimit të licensës.

## **Kapitulli III – Kushtet e Licencës**

### **Neni 12 – Detyrimet e të licencuarit**

I licencuari është i detyruar:

1. të zbatojë legjislacionin në fuqi, rregullat, procedurat, metodikat, standartet e miratuara nga ERRU.
2. të aplikojë brenda 30 ditëve për tarifën e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit apo trajtimit të ujërave të ndotura.
3. të zbatojë tarifën për kategoritë e shërbimit të aprovuara në licencën e dhënë e të miratuara nga KKRR.
4. të bëjë furnizimin me ujë të konsumatorit në përputhje me standartet teknike të miratuara nga DPS dhe ERRU.
5. për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë së ujit sipas standarteve të përcaktuara me VKM nr. 145, datë 26.02.1998 “Për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm”.
6. të bëjë njoftime publike si për ndërprerjet e furnizimit me ujë në rast avarie ashtu dhe për ndërprerjet e furnizimit me ujë të planifikuara.

7. të bëjë transparencën me konsumatorët para se të bëjë propozimin për ndryshimin e tarifave. Një kopje të raportit mbi transparencën duhet të dërgohet në ERRU, së bashku me propozimin e tarifave të reja.
8. të përdorë të gjitha mjetet që i njeh ligji, për të siguruar financimin e veprimtarive të licencuara.
9. të paguajë, për licencën e marrë apo rinovimin e saj, tarifën e përcaktuar nga ERRU për to (shih tabelën bashkëlidhur).

I licencuari nuk ka të drejtë të bëjë marrëveshje me një person të tretë, për shitjen e ujit të pijshëm për qëllime tregtare, pa miratimin e ERRU.

I licencuari do të njoftojë në ERRU brenda 30 ditëve për çdo ndryshim të:

- adresës;
- drejtuesit ligjor apo teknik;
- kushteve të licencës;
- zonës së shërbimit
- skemave të sistemeve të furnizimit me ujë si dhe largimit apo trajtimit të ujërave të ndotura.

Të gjitha njoftimet zyrtare, aplikimet, korespondenca me ERRU-në lidhur me detyrimet sipas kësaj Licence, duhet të jenë me shkrim. Të gjithë njoftimet dhe korespondenca do të konsiderohen se hyjnë në fuqi nga momenti i dorëzimit.

Kushtet e detajuara të licencës dhe certifikata e licencës gjendet në aneksin 6 të rregullores.

### **Neni 13 – Pagesat e licencimit**

- I licensuari do të paguajë pagesën e licencimit sipas vlerave të përcaktuara nga KKRR në tabelen bashkëlidhur.
- Pagesa do të kryhet në nr. e llogarisë së Entit Rregullator të Ujit.

### **Neni 14 – Kontrolli mbi kryerjen e aktivitetit të licencuar**

ERRU do të kontrollojë zbatimin e kushteve të licencës nga i licencuari.

ERRU ka të drejtë të shqyrtojë dokumentat e të licencuarit, për të verifikuar përputhjen e kryerjes së aktivitetit të licencuar me kushtet e licencës, si dhe rregullat, standartet dhe vendimet e ERRU-së. I licensuari do të sigurojë çdo informacion të këkuar nga ERRU.

Nëse pas kontrollit, ERRU-ja konkludon se i licensuari nuk ka zbatuar Kushtet e Licencës mund të marrë masa të tjera brenda qëllimit të autoritetit të tij për të mbrojtur interesat e konsumatorëve.

I licencuari do të japë shpjegimet dhe arsyet për çdo shkelje të kushteve të licencës brenda **15 ditëve** nga momenti kur kjo shkelje i bëhet e njohur zyrtarisht me shkrim nga ERRU.

### **Neni 15 – Rastet e Konfliktit**

- KKRR do të marrë vendimet përkatëse sipas ligjeve në të gjitha rastet kur i licencuari nuk zbaton ligjin, rregullat e përcaktuara nga ERRU, kushtet e licencës, standardet dhe detyrimet me konsumatorët.
- Kur një i licencuar nuk zbaton ligjet apo shkel kushtet e licencës së tij, KKRR do të nxjerrë një urdhër me shkrim për të siguruar zbatimin e tyre. Në këtë rast KKRR duhet:
  - të njoftojë me shkrim të licencuarin për nxjerrjen e urdhërit;
  - të parashtrijë faktet që argumentojnë nxjerrjen e urdhërit;
  - ti japë mundësi të licencuarit, që brenda afatit të paraqesë opinionin e tij;
  - të shqyrtojë opinionin dhe shpjegimet e të licensuarit dhe nëse e gjykon të arsyeshme të modifikojë urdhrin e nxjerrë në bazë të tyre;
  - të hartojë një urdhër përfundimtar dhe një kopje të tij t’ia japë të licencuarit;
  - të botojë urdhërin e nxjerrë në mënyrën, që ai e sheh të arsyeshme;
  - të fillojë veprimet administrative në bazë të urdhërit.
- Të drejtat e të licencuarve në rastet e konfliktit

Operatorët që do të ushtrojnë veprimtaritë e tyre në sektorin e grumbullimit, shpërndarjes së ujit për konsum publik, trajtimit si dhe grumbullimin, trajtimin dhe largimin e ujrave të ndotura, kanë të drejtë, si më poshtë:

- të drejten për t’u përfaqësuar;
- mundësinë për t’u dëgjuar dhe të drejten për të pyetur ;
- mundësinë për të paraqitur evidenca për t’u mbrojtur;
- mundësinë për të paraqitur mbrojtje me shkrim dhe argumenta;
- paanshmërinë e atyre që marrin vendimin dhe të drejtën për të apeluar.

## **Neni 16 – Sanksionet**

Në bazë të nenit 19 të ligjit nr. 8102, datë 23.03.1996 (të ndryshuar) për “Kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, KKRR ka të drejtë të:

- a) pezullojë licencën e një të licencuari nëse:
  - ai nuk i përgjigjet legjislacionit në fuqi dhe akteve nënligjore të nxjerra nga KKRR
  - ai shkel kushtet e licencës;
  - nuk paraqitet brenda afatit të caktuar nga Komisioni për ndryshimin e kushteve të licencës.
  
- b) të revokojë kushtet e një licence kur:
  - në veprimtarinë e të licencuarit konstaton shkelje të rënda të kushteve të licencës;

KKRR do të ndërmarrë hapat e nevojshëm ligjorë për çdo person fizik apo juridik, sipas ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, të ndryshuar, neni 32/1, në rastet kur ky operator kryen aktivitetet e grumbullimit, shpërndarjes së ujit për konsum publik dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura pa patur licence nga KKRR.

***Moszbatimi i kushteve të licencës, dënohet me gjobë në shumën 50 000 lekë.***

## **Neni 17 – Hyrja në Fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas aprovimit nga KKRR.

## KËRKESË PËR LICENCIM

### Emërtimi i operatorit që kërkon licencim

---

**Adresa e plotë:** \_\_\_\_\_

**Telefon / mobil / e-mail:** \_\_\_\_\_

**Drejtues ligjor:** \_\_\_\_\_

*(emër, atësi, mbiemër)*

### Drejtues teknik *(me të cilët kërkon të marrë licencën)*

1. \_\_\_\_\_

*(emër, atësi, mbiemër, titull diplome, vit diplomimi)*

2. \_\_\_\_\_

*(emër, atësi, mbiemër, titull diplome, vit diplomimi)*

### APLIKON PËR:

*(vendosni shenjë në kutinë në krah të aplikimit që kryeni)*

1. LICENCIM PËR HERË TË PARË

2. RINOVIM LICENCE PËR EFEKT TË NDRYSHIMIT:

a) Të drejtuesit ligjor

b) Të drejtuesit teknik

c) Të kategorive të shërbimit

d) Të popullsisë në zonën e shërbimit

***Drejtuesi ligjor***

*(emër. mbiemër. firma. vula)*

## FORMULARI I APLIKIMIT

<b>I – Shërbimi që kërkohet të ofrohet</b>		
a) <b>Kategoria A</b> , për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik	Po .....	Jo .....
b) <b>Kategoria B</b> , për përpunimin e ujit për konsum publik	Po .....	Jo .....
c) <b>Kategoria C</b> , për largimin e ujërave të ndotura	Po .....	Jo .....
ç) <b>Kategoria D</b> , për përpunimin e ujërave të ndotura	Po .....	Jo .....

<b>II – Zona e Shërbimit dhe Popullsia që i shërbehet nga Operatori</b>				
(Bashkëngjitur të jepet harta, skema e zonës së shërbimit ku të përfshihen të gjitha objektet kryesore si stacioni i pompave, depot, linjat kryesore të dërgimit dhe të shpërndarjes së ujit për konsum publik, vendet e shkarkimit të ujërave të ndotura sëbashku me disa të dhëna kryesore teknike të tyre)				
Emri i Bashkisë, komunës, fshatit dhe numri i popullsisë së regjistruar.  <i>Aplikuesi duhet të rradhisë të gjitha qendrat urbane nën juridiksionin e njësive përkatëse të cilave do tju shërbehet pas marrjes së licencës nga ERRU.  Aplikuesi duhet të japë numrin e popullsisë përkatëse të regjistruar në zyrat e gjendjes civile të qendrës urbane për vitin e fundit para aplikimit.</i>	<b>Nr.</b>	<b>Bashki Emër / Popullsia</b>	<b>Komunë Emër / Popullsia</b>	<b>Fshat Emër/Popullsia</b>

<b>III – Burimet e furnizimit me ujë për konsum publik dhe trajtimi i ujit të pijshëm</b>				
<b>Burimet</b>	<b>Vendndodhja</b>	<b>Kapaciteti max</b>	<b>Kapaciteti shfrytëzues (l/s)</b>	<b>Lloji i marrjes së ujit (Burim, pusçpim, liqen, etj)</b>
<b>Trajtimi i ujit të pijshëm</b>		Po..... Jo..... Nëse po jepni të dhëna për Impiantin e trajtimit: Tipin e trajtimit: ..... Kapaciteti ..... Popullsia .....		

<b>IV – Rezervuarët e Ujit për konsum publik</b>		
<b>Rezervuari</b>	<b>Vendndodhja</b>	<b>Kapaciteti rezervues</b>

<b>V – Cilësia e ujit për konsum publik</b>	
a. Të dhënat kryesore në lidhje me karakteristikat cilësore të ujit që përdoret për konsum publik	PH=..... NH <sub>4</sub> <sup>+</sup> =..... NO <sub>2</sub> =.....

të shoqëruar me fletën e analizave të cilësisë së ujit në muajin e aplikimit për licence të përgatitur nga Inspektoriati Sanitar Shtetëror përkatës	NO <sub>3</sub> =..... PO <sub>4</sub> =..... CO <sub>3</sub> =..... HCO <sub>3</sub> =..... Lengje Organike=.....
b. Lloji i dezinfektimit të ujit për konsum publik (hipoklorit kalcium, hipoklorit natriumi, etj)	..... ..... ..... .....
c. Vendndodhja dhe tipi i pajisjeve të dezinfektimit të ujit për konsum publik)	..... ..... ..... .....

<b>VI – Shkarkimet e ujërave të ndotura dhe trajtimi i ujërave të ndotura</b>	
a. Vendndodhja	..... ..... ..... .....
Trajtimi i ujërave të ndotura	Po..... Jo..... Nëse po jepni të dhëna për Impiantin e trajtimit: Tipin e trajtimit:..... Kapacitetin:..... Popullsia: .....

<b>VII – Informacion për personelin</b>	
a. Numri total i punonjësve me orar të plotë dhe me kontratë	
b. Numri i punonjësve në sektorin e Furnizimit me ujë	

c. Numri i punonjësve në sektorin e KUZ	
d. Numri i punonjësve të Administratës përfshi drejtuesit	

**Drejtuesi Ligjor i Operatorit**

---

*(emri, mbiemri, firma, vula)*

Dokumentat Ligjore bashkëngjitur këtij formulari në përputhje me VKM Nr. 958, dt. 06.05.2009

*II. Personat, fizik apo juridik, për t'u pajisur me licencë për ushtrimin e veprimtarisë në sistemet e furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura duhet të dorëzojnë, pranë ERRU-së dokumentet e mëposhtme:*

1. Kërkesë me shkrim për aplikim për licencë, sipas formës së kërkuar nga ERRU-ja.
2. Dokumentin e regjistrimit ligjor të operatorit, si person fizik apo juridik në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
3. Autorizimin nga pronari për drejtuesin ligjor, i cili i jep të drejtën për të kryer të gjitha veprimtaritë për aplikimin dhe përdorimin e licensës përkatëse;
4. Dokumentin e regjistrimit në organet tatimore të zonës administrative, ku kërkohet të kryhet shërbimi;
5. Lejen higjieno – sanitare nga Inspektoriati Sanitar Shtetëror i zonës administrative, ku kërkohet të kryhet shërbimi;
6. CV e drejtuesit ligjor dhe teknik.
7. Lejen e mjedisit, kur kërkohet licencë për përpunimin e ujërave të ndotura;
8. Dokumentat e kualifikimit të drejtuesit teknik si më poshtë vijon:
  - a) Për sistemet e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, Drejtuesi teknik duhet të ketë diplomë universitare në degët e inxhinierisë hidroteknikë, ndërtim, inxhinjeri elektrike, mekanike, mjedis apo disiplina të ngjashme si dhe një përvojë pune mbi 5 vjet në këtë sektor.
  - b) Në rastet kur operatori do të ushtrojë veprimtarinë për përpunimin e ujërave për konsum publik apo për përpunimin e ujërave të ndotura, ai duhet të ketë edhe një drejtues teknik të kualifikuar me diplomë universitare, në degët e inxhinierisë hidroteknike, mjedisit, inxhinjeri elektrike, mekanike, kimike, mikrobiologjike apo disiplina të tjera të ngjashme.
9. Dëshmitë e penaltetit për drejtuesin ligjor dhe teknik.
10. Deklaratën me shkrim e drejtuesit ligjor dhe atij teknik, ku të deklarojë me përgjegjësi zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore të nxjerra nga ERRU-ja, të

standarteve shqiptare për veprimin dhe mirëmbajtjen e sistemit e të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Procesi i sigurimit të dokumentacionit të mësipërm nga ERRU-ja zgjat jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga dita e aplikimit për licencë nga subjekti përkatës.

**Shënim:** Ju lutemi na dërgoni të plotësuar këtë formular dhe një kopje të mandatit të arkëtimit në adresën e mëposhtme:

## VETDEKLARIMI I DREJTUESIT LIGJOR

*“Deklaroj në përgjegjësinë time, që do të ndjek me përpikmëri zbatimin e akteve ligjore si dhe akteve nënligjore të nxjerra nga ERRU-ja, të standarteve shqiptare për veprimin dhe mirëmbajtjen e sistemit si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi”.*

**Deklaruesi**

---

*(emër, mbiemër, firma)*

## VETDEKLARIMI I DREJTUESIT TEKNIK

*“Deklaroj në përgjegjësi time, që do të ndjek me përpikmëri zbatimin e akteve ligjore si dhe akteve nënligjore të nxjerra nga ERRU-ja, të standarteve shqiptare për veprimin dhe mirëmbajtjen e sistemit si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi”.*

**Deklaruesi**

---

*(emër, mbiemër, firma)*

## PAGESAT PËR LICENCIM

Sipas kategorive të përcaktuara në Vendim nr. 958, datë 06.05.2009 për shoqëritë  
UK që ende nuk janë riorganizuar sipas VKM nr. 302, datë 11.05.2022

POPULLSIA E ZONËS SË MBULIMIT	PAGESAT			
	Kategoria A, grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik	Kategoria B, për përpunimin e ujit për konsum publik	Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura	Kategoria D, për përpunimin e ujërave të ndotura
deri në 10.000 banorë	10,000	10,000	10,000	10,000
10.000 - 50.000 banorë	20,000	20,000	20,000	20,000
50.000 - 150.000 banorë	30,000	30,000	30,000	30,000
mbi 150.000 banorë	50,000	50,000	50,000	50,000

### Shënim:

1. Operatorët do të bëjnë pagesat sipas tabelës së mësipërme në rast ndryshimi të kategorisë së shërbimit apo të popullsisë në zonën e shërbimit.

## PAGESAT PËR LICENCIM

Sipas kategorive të përcaktuara në Vendim nr. 958, datë 06.05.2009 për shoqëritë të riorganizuara sipas VKM nr. 302, datë 11.05.2022

POPULLSIA E ZONËS SË MBULIMIT	PAGESAT			
	Kategoria A, grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik	Kategoria B, për përpunimin e ujit për konsum publik	Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura	Kategoria D, për përpunimin e ujërave të ndotura
50.000 - 100.000 banorë	60 000	60 000	60 000	60 000
100.000 - 150.000 banorë	80 000	80 000	80 000	80 000
150.000 - 200.000 banorë	120 000	120 000	120 000	120 000
200.000 – 500.000 banorë	150 000	150 000	150 000	150 000
Mbi 500.000 banorë	170 000	170 000	170 000	170 000
Ndryshim Drejtuesi Ligjor	40 000			
Ndryshim Drejtuesi Teknik	40 000			

### **Shënim:**

Operatorët do të bëjnë pagesat sipas tabelës së mësipërme në rast ndryshimi të **kategorisë** së shërbimit, të **popullsisë** në zonën e shërbimit apo ndryshim drejtuesi ligjor dhe/ose Teknik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT  
ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT  
TË UJËRAVE TË NDOTURA



# LICENCË

Nr. \_\_\_\_

PËR  
GRUMBULLIMIN, SHPËRNDARJEN, PËRPUNIMIN E UJIT PËR KONSUM PUBLIK  
DHE LARGIMIN E PËRPUNIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA

Vendimi Nr. \_\_\_\_, dt. \_\_\_\_.\_\_\_\_.\_\_\_\_ i KKRr

**Operatori:** Shoqëria Anonime Ujësjetllës Kanalizime .....

**Adresa:** .....

**Afati i Licencës:** Nga ..... deri më .....

**Zona e Shërbimit:** Bashkia:

**Kategoritë e shërbimit:**

1. Kategoria A Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik
2. Kategoria B Për përpunimin e ujit për konsum publik
3. Kategoria C Për largimin e ujërave të ndotura
4. Kategoria D Për përpunimin e ujërave të ndotura

**Kushtet e licencës:**

Kjo licencë lëshohet në përputhje me ligjin nr. 8102, dt.28.03.1996, i ndryshuar, si dhe të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kushtet e licencës sipas tekstit bashkëlidhur, janë pjese e pandarë e kësaj licence. Operatori në ushtrimin e aktivitetit të tij, vepron në pajtim me kushtet e përcaktuara të licencës.

PËR KOMISIONIN KOMBËTAR RREGULLATOR  
**ZNJ. GERTA LUBONJA**  
**KRYETAR**

**KUSHTET E LICENCËS**

**PËR**

**GRUMBULLIMIN, SHPËRNDARJEN, PËRPUNIMIN E UJIT PËR KONSUM**

**PUBLIK**

**DHE LARGIMIN E PËRPUNIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA**

Nr. i Licencës \_\_\_\_\_, Vendimi i KKRr \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_

I jepet: \_\_\_\_\_

(Emri i plotë i të Licencuarit)

Enti Rregullator i Ujit harton këto kushte licence, të detyrueshme për tu zbatuar nga operatori në ushtrimin e veprimtarisë së tij, gjatë të gjithë periudhës së vlefshmërisë së licencës.

Këto kushte hartohen në zbatim të legjislacionit në fuqi në sektorin ujësjellës-kanalizime. Për sa nuk parashikohen në këto kushte licence, zbatohen aktet ligjore e nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë;

**Përkufizime**

**1. Fjalët dhe frazat e përdorura në kushtet e licencës kanë këtë kuptim:**

- **“ERRU”** është Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujrave të Ndotura që vepron sipas Ligjit Nr. 8102, date 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”;
- **“KKRR”** është Komisioni Kombëtar Rregullator që udhëheq Entin Rregullator të Ujit që funksionon në bazë të ligjit nr. 8102 (i ndryshuar).
- **“Licencë”** do të thotë leja profesionale që i jepet një personi fizik apo juridik në përputhje me ligjin Nr. 8102, datë 28.03.1996 të ndryshuar si dhe VKM Nr. 958, datë 06.05.2009 për ushtrimin e aktivitetit në sektorin e furnizimit me ujë, largimit të ujërave të ndotura dhe përpunimit të tyre;

- **“I licencuar”** do të thotë një person juridik apo fizik që mban një licencë të dhënë nga ERRU për të operuar në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura sipas kategorive të dhëna nga KKRR;
- **“Certifikatë e Licencës”** do të thotë formati i lejes profesionale, miratuar nga KKRR;
- **“Dokumentat e Aplikimit”** do të thotë dokumentat e përcaktuara në VKM Nr. 958, date 06.05.2009 dhe Rregulloren e licencimit miratuar nga Komisioni;
- **“Pagesa e licencimit”** janë pagesa, të vendosura sipas ligjit, të detyrueshme për të licencuarin që operojnë në sistemet e furnizimit me ujë dhe sistemet e kanalizimeve të cilat duhet të bëhen përpara marrjes së Licencës përkatëse;
- **“Drejtues ligjor”** do të thotë personi fizik i emëruar apo të caktuar me një marrëveshje juridike, nga pronari për të administruar në përputhje me ligjin në sistemet përkatëse të furnizimit me ujë, largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura;
- **“Drejtues teknik”** do të thotë një individ me aftësitë e duhura për drejtimin teknik të Operatorit të licencuar nga KKRR i cili përmbush të gjitha kriteret e kërkuara nga ligji dhe VKM Nr. 958, datë 06.05.2009;
- **“Konsumatorë”** janë të gjithë kategoritë e përfituesve familjarë, publikë dhe privatë (të tanishëm dhe në të ardhmen) të cilët përdorin shërbimet e furnizimit me ujë dhe/ose kanalizimeve;
  - **Konsumator familjarë** nënkupton ata konsumatorë që i shfrytëzojnë shërbimet UK në objektin e banimit;
  - **Konsumatore private** nënkupton ata konsumatorë që përcaktohen nga legjislacioni në fuqi si persona fizike e juridike me natyrë tregëtare;
  - **Konsumatorë publikë** nënkupton subjektet ligjore të tilla si insitucione qëndrore, vendore, ente publike, si dhe çdo organ tjetër të administratës shtetërore që nuk ka natyrë tregëtare.
- **Sistemi i furnizimit me ujë** përbëhet nga tërësia e elementëve si vepra e marrjes, sistemi i pompave, njësitë e dezinfektimit, rezervuarët, linjat e transmetimit dhe rrjeti shpërndarës;
- **Sistemi i kanalizimeve** është sistemi që përbëhet nga tërësia e elementëve si linjat e shkarkimit/grumbullimit të ujërave të ndotura, linjat e largimit dhe/ose stacionet e pompimit të ujërave të ndotura, veprat e shkarkimit të tyre në trupat ujore pritëse si dhe impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura (nëse sistemi është i pajisur me to);

- **Shërbimet UK** është tërësia e shërbimeve të kryera nga operatorët tek konsumatorët përmes sistemeve të furnizimit me ujë si dhe sistemeve të grumbullimit, largimit dhe/ ose trajtimit të ujërave të ndotura;
  - **“Zona e shërbimit”** është zona, ku operatori i licencuar është përgjegjës të ofrojë shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime;
  - **“Tarifë”** është çmimi për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujrave të ndotura i miratuar nga KKRR;
2. Fjalët dhe frazat e tjera të përdorura në këto kushte licence kanë të njëjtin kuptim me ato të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore të sektorit ujësjellës-kanalizime.

### **Të përgjithshme**

3. Enti Rregullator i Ujit është autoriteti i vetëm në Republikën e Shqipërisë, i njohur sipas ligjit nr.8102, date 28.03.1996, për “Kudrin ligjor të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, që lëshon dhe deklaron hyrjen në fuqi të kësaj Licence.
4. I licencuari është i detyruar të zbatojë legjislacionin në fuqi, rregullat, procedurat, metodikat, standartet e miratuara nga ERRU.
5. Kohëzgjatja e kësaj Licence është 4 (katër) vjet. Kohëzgjatja përcaktohet nga performanca dhe qëndrueshmëria e shoqërisë që licencohet dhe do të pasqyrohet në certifikatën e licencës.
6. Kjo Licencë nuk mund ti transferohet te treqete pa miratimin paraprak me shkrim të KKRR. Kur miraton një transferim, KKRR mund ta modifikojë periudhën e Licences ose Kushtet e tjera te Licences
7. KKRR me iniciativën e vet dhe /ose me kërkesë të të licencuarit mund të ndryshojë licencën dhe kushtet e licencës, në përputhje me nenin 17 dhe 18 të ligjit 8102. I licencuari mund të kërkojë ndryshim të kësaj Licence nëpërmjet një kërkesë të detajuar me shkrim, shoqëruar me arsyet përkatëse. Një kërkesë e tillë mund të miratohet vetëm nëse ky ndryshim nuk çon në ulje të cilësisë së shërbimit, ose në rritje të çmimeve dhe tarifave për klientët e të Licencuarit;
8. KKRR ndryshon licencën në rastet e mëposhtme:
  - Kur ka ndryshime në elementët e licencës;

- kur rrezikohet jeta e qytetarëve ose dëmtimi i shëndetit të tyre, si dhe dëmtimi i mjedisit ose dëmtimi i pasurisë së palëve të treta, kur rreziku nuk kërkon heqjen e Licencës;
  - kur në Licencë është bërë një gabim i qartë faktik;
  - kur ka ndryshime në kuadrin ligjor të sektorit të shërbimeve ujësjellës-kanalizime, pa përjashtuar ndryshimet në kuadrin ligjor kombëtar, ndryshime të rrethanave të lëshimit të licencës, vendime të formës së prerë të gjykatës, ose ngjarjeve që ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në administrimin e sistemeve të furnizimit me ujë, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura, etj.
9. I licencuari duhet t'i parashtojë ERRU-së një kërkesë me shkrim për rinovimin e Licencës jo më pak se 3 muaj para përfundimit të afatit të Licencës së dhënë. Afati i Licencës do të zgjatet kur KKRR, bazuar në ligjin nr.8102, Rregulloren e licencimit dhe në prova të besueshme, konkludon se i Licencuari i ka përmbushur Kushtet e Licencës dhe i është përmbajtur kërkesave të gjithë legjislacionit në fuqi gjatë afatit të Licencës.
  10. I licencuari është i detyruar të paguajë, për aplikimin për licencën dhe rinovimin e saj, tarifën e përcaktuar nga ERRU.
  11. Kjo Licencë mund të transferohet vetëm me vendim me shkrim të KKRR dhe sipas afateve dhe kushteve të vendosura nga ai. KKRR transferon licencën vetëm nëse gjykon se personi të cilit i transferohet Licenca ka aftësinë teknike dhe financiare për të plotësuar afatet dhe kushtet e kësaj Licence.
  12. Çdo transferim i kësaj Licence pa miratimin e KKRR është i pavlefshëm dhe përbën një shkelje të kësaj Licence.
  13. I licencuari është i detyruar të paguajë për aplikimin për licencë dhe rinovimin e saj, tarifën e përcaktuar nga KKRR.
  14. I licencuari do të paguajë rregullisht dhe në mënyrë të vazhdueshme pagesat e rregullimit gjatë kohëzgjatjes së kësaj Licence siç përcaktohet nga ligji 8102.
  15. I licencuari duhet të njoftojë ERRU jo më vonë se 30 ditë, kur ndërmerret ndonjë veprimtari tjetër përveç veprimtarisë për të cilën është licencuar.
  16. KKRR mund ta ndalojë të licencuarin të kryejë ndonjë veprimtari tjetër përveç asaj të licencuar, ose mund të vendosë kushte për kryerjen e kësaj veprimtarie, me qëllim mbrojtjen e konsumatorve.
  17. I Licencuari duhet t'i paraqesë ERRU çdo informacion që është i domosdoshëm për njohjen e situatës nga ERRU për të kryer përgjegjësitë rregullatore sipas ligjit. Informacioni duhet të paraqitet sipas formës dhe brenda kohës së vendosur nga ERRU.

18. ERRU ka të drejtë të kontrollojë zbatimin e kushteve të licencës, dokumentacionin e të licencuarit dhe çdo të dhënë tjetër për të verifikuar përputhjen e kryerjes së aktivitetit me kushtet e licencës, rregullat dhe standartet në fuqi.
19. Përfaqësuesit e autorizuar të ERRU kanë të drejtë të inspektojnë dokumentacionin e veprimtarisë, ambientet dhe pajisjet e të licencuarit.

### **Veprimtaria e të licencuarit**

20. I licencuari autorizohet nga kjo licencë për kryerjen e veprimtarisë sipas kategorive të përcaktuara në licencë brenda zonës së shërbimit. Kjo e drejtë i jepet ekskluzivisht të licencuarit.
21. Gjatë afatit të licencës, i licencuari ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimtaritë që kërkohen për përmbushjen e licencës. I licencuari mund të përdorë të gjitha mjetet që i njeh ligji, për të siguruar financimin e veprimtarive të licencuara.
22. I licencuari në marrdhëniet me konsumatorët zbaton kushtet e kontratës model të aprovuar nga KKRR, përfshirë furnizimin në sasi dhe cilësinë e duhur me ujë për konsum publik dhe mbledhjen dhe largimin e ujrave të ndotura për të gjitha kategoritë e konsumatorëve.
23. I licencuari nuk ka të drejtë të vendosë tarifa për konsumatorët, përveç atyre të miratuara nga KKRR dhe ato që lejojnë aktet normative në sektor.
24. I licencuari gjatë ushtrimit të veprimtarisë nuk mund të bashkëpunojë me të licencuar të tjerë në dëm të konsumatorëve.
25. I licencuari duhet të kryejë veprimtarinë e tij në përputhje me parimet e efikasitetit ekonomike, duke patur si objektiv arritjen e kostove më të ulta, dhe duke zbatuar njëkohësisht standartet dhe objektivat e përcaktuara nga KKRR.
26. I licencuari nuk do të hyjë në asnjë marrveshje që mund të rezultojë në shkelje të Kushteve të Licencës ose të ndonjë dispozite tjetër ligjore e nënligjore në fuqi.
27. I licencuari nuk do të angazhohet në veprimtari të tjera që pengojnë ose mund të pengojnë kryerjen si duhet të veprimtarisë së licencuar.
28. I licencuari nuk do të pengojë, parandalojë ose të përpiqet të parandalojë të licencuar të tjerë apo konkurrenca potencialë që të angazhohen ligjërisht në tregun e sektorit ujësjellës-kanalizime.
29. I licencuari duhet të dorëzojë pranë ERRU, deri në 31 dhjetor të çdo viti një raport vjetor lidhur me veprimtarinë e tij gjatë vitit të mëparshëm kalendarik, i cili përmban:

- Të dhënat për treguesit e performancës së miratuar nga KKRR;
  - Regjistri i konsumatorit sipas modelit të miratuar nga KKRR;
  - Bilancin e Ujit;
  - Kostot
  - Të dhëna mbi zbatimin e kontratës model;
  - Numrin e ankesave dhe problematikat kryesore;
  - Çdo problem që shfaqet gjatë vitit;
- 30.** I licencuari do të dorëzojë në KKRR deri në fund të muajit prill të çdo viti, raportin e ekspertit kontabël dhe pasqyrat kontabël të sipërmarrjes së tij dhe të çdo njësie biznesi të veçantë në atë formë dhe me atë nivel detajesh siç dorëzohet në organet tatimore.
- 31.** I licencuari do ta njoftojë ERRU brenda 30 ditëve për çdo ndryshim të:
- adresës;
  - statutit të të licencuarit;
  - certifikates së regjistrimit;
  - drejtuesve ligjor dhe teknik;
  - aksioneve deri në 5%.
  - ndryshim të rrethanave që ndikojnë në kushtet e licencës;
  - zonës së shërbimit
  - skemave të sistemeve të furnizimit me ujë si dhe largimit apo trajtimit të ujrave të ndotura.
- 32.** I licencuari punëson një ose më shumë drejtues të teknike për ushtrimin e aktivitetit të tij. Marrdhëniet e punës vërtetohen me kontratë noteriale, një kopje e të cilës i vihet në dispozicion ERRU. I licencuari nuk mund të ushtrojë veprimtarinë e tij në mungesë të drejtuesit/ve teknikë.
- 33.** Drejtuesi teknik është punonjës me kohë të plotë. Ai nuk mund të jetë i punësuar në një ose me shumë operatorë të tjerë shërbimi ujësjellës-kanalizime.
- 34.** Kur drejtuesi ligjor dhe/ose drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me pa aftësi ushtrimi detyre mbi 3 muaj, invaliditet, ndarje nga jeta), i licencuari njofton ERRU dhe dërgon dokumentacionin përkatës për drejtuesin e ri ligjor apo teknik.
- 35.** Licenca e shërbimit rinovohet sa herë që ka ndryshime në zonën e juridiksionit, kategorive të shërbimit dhe në rastet e riorganizimit të shoqërisë, pavarësisht se afati i vlefshmërisë nuk ka përfunduar. I licencuari paraqet aplikimin për rinovim licence për shkaqet e mësipërme brenda 30 ditëve nga lindja e tyre.

36. I licencuari, jo më vonë se 3 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës, paraqet pranë ERRU kërkesën për rinovimin e licencës shoqëruar me dokumentat e mëposhtme:
- Kërkesën me shkrim për licencim sipas formatit të aprovuar nga ERRU duke shprehur qartë kategoritë e shërbimit që kërkon të kryejë si dhe zonën e juridiksionit ku do të operojë.
  - Formularin e aplikimit aprovuar nga ERRU dhe të plotësuar sipas kërkesave të ligjit, VKM dhe Rregullores së licencimit të ERRU.
  - Dokumentacionin e kërkuar sipas VKM Nr.958, datë 06/05/2009
  - Në kërkesën për rinovim të licencës, i licencuari paraqet ndryshimet në kushtet e saj, nëse ka të tilla, ose konfirmon kushtet aktuale të licencës.
37. I licencuari është i detyruar të kryejë veprimtaritë e specifikuara në Licencë. Nëse gjatë kryerjes së veprimtarisë së licencuar, shfaqen rrethana për të cilat i licencuari në mënyrë të arsyeshme nuk është në gjendje të kryejë veprimtaritë e specifikuara në Licence, i licencuari do të njoftojë menjëherë KKRR dhe do të ndjek udhëzimet e tij.
38. I licencuari nuk ka të drejtë të bëjë marrëveshje me një person të tretë, për shitjen e ujit të pijshëm me shumicë për qëllime tregtare, pa miratimin e KKRR.
39. E gjithë korrespondenca zyrtare do të jetë në formë shkresore.
40. Veprimtaria e të licencuarit për operimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve nën administrim duhet të bëhet në përputhje me rregullat e mbrojtjes dhe sigurisë në punë.
41. Mbrojtja e objekteve të burimeve ujore dhe sistemeve nën administrimin duhet të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **Kryerja e shërbimit**

42. I licencuari do t'u sigurojë akses në sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve dhe do të trajtojë konsumatorët e tij në bazë të drejtë, të arsyeshme dhe jo-diskriminuese.
43. I licencuari duhet të zbatojë tarifën e miratuara nga KKRR për kategoritë e shërbimit, sipas kategorive të konsumatorve.
44. I licencuari para se të bëjë propozimin për ndryshimin e tarifave duhet të organizojë seancën dëgjimore me publikun, sipas përcaktimeve të metodologjisë së tarifave
45. Operatori nuk ka të drejtë të aplikojë për tarifë në shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujrave të ndotura në rast se nuk është i licencuar apo në rast se i ka mbaruar afati i licencës.

46. I licencuari është i detyruar për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë së ujit sipas standarteve të cilësisë së ujit të miratuara me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
47. I licencuari duhet të sigurojë ndjekjen dhe zgjidhjen në kohë të ankesat e konsumatorve. ERRU në bazë të një ankese ose edhe me iniciativën e vet mund të nisë një hetim për respektimin nga i licencuari të akteve normative, kushteve të licencës dhe rregullave të tjera të KKRR.
48. Rekomandimet e ERRU mbi ankesat e konsumatorve janë të detyrueshme për tu zbatuar.
49. I licencuari do të përgatisë dhe përditësojë regjistrin e aseteve të veta.

### **Pezullimi dhe heqja e licencës**

50. KKRR mund të pezullojë licencën e të licencuarit nëse:
  - ai nuk zbaton legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore të nxjerra nga KKRR;
  - ai shkel kushtet e licencës;
  - nuk paraqitet brenda afatit të caktuar nga KKRR për ndryshimin e kushteve të licencës.
51. KKRR mund të heqë Licencën sipas ligjit nr.8102, dhe procedurave të përcaktuara në rregullat e ERRU kur:
  - I licencuari shkel në mënyrë të përsëritur Kushtet e Licencës
  - I licencuari shkel në mënyrë të përsëritur legjislacionin në fuqi;
  - I licencuari kërkon heqjen e Licencës;
  - I licencuari e ka marrë licencën me mashtrim.
  - I licencuari deklarohehet i falimentuar dhe nuk është i aftë të kryejë detyrimet sipas Kushteve të kësaj Licence.
  - Shkrihet personi që mban Licencën.

Pezullimi dhe heqja e licencës nuk përjashton mundësinë për vendosjen e sanksioneve monetare sipas akteve ligjore në fuqi.

**Moszbatimi i kushteve të licencës dënohet me gjobë në shumën 50.000 lekë.**